

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-26-4567-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi,Dezinsektimi,DeratizimiI hapsirave ne institucionin public në Komunën e Gjilanit “**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	MONUNI SH.P.K
NUI	811431238
Adresa	Rr. Washingtonit nr.65
Vendi	GJILAN
Kodi postar	60000
Numri Telefonit	043/555/655
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Uron Maloku
Adresa elektronike	research@monuni.com
Data e parashtrimit të ankesës	02.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Dezinfektimi,Dezinsektimi,DeratizimiI hapsirave ne institucionin public në Komunën e Gjilanit “

Më 31.08.2026 është publikuar versioni i korrigjuar i Dosjes së Tenderit.

Më 01.09.2026 është publikuar Njoftimi për Korrigjim B54.

Afati i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave është caktuar më 04.09.2026 në ora 14:00.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

MONUNI SH.P.K. ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim më 01.09.2026, lidhur me Dosjen e Tenderit të korrigjuar dhe B54 për aktivitetin nr. 651-26-4567-2-1-1.

Me vendimin e datës 02.09.2026, Autoriteti Kontraktues e ka hedhur kërkesën si të palejuar, duke konsideruar se është paraqitur jashtë afatit.

Megjithatë, Dosja e Tenderit e korigjuar është publikuar më 31.08.2026, ndërsa afati për ofertim është caktuar më 04.09.2026, çka e ka bërë objektivisht të pamundur paraqitjen e Kërkesës për Rishqyrtim së paku pesë ditë para ofertimit.

Pra, pamundësia për respektimin e afatit është shkaktuar nga vetë veprimi i AK-së, jo nga mosveprimi i MONUNI SH.P.K. Vendimi i AK-së i datës 02.09.2026 bashkëngjitet kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 5 i LPP-së - Llogaritja e afateve kohore.

Neni 7, paragrafët 2 dhe 6 të LPP-së - Konkurrenca dhe pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë.

Neni 44.1 i LPP-së - Afatet për përgatitjen dhe dorëzimin e tenderëve.

Neni 46.1 i LPP-së - Kushtet për përdorimin e afateve të përshpejtuara.

Neni 53.7 i LPP-së - Zgjatja e afatit pas dhënies së informatave shtesë ose sqaruese.

Neni 24.5 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar.

Neni 24.7 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar.

Neni 60.1(a) i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Autoriteti Kontraktues ka publikuar dokumentacionin e korrigjuar në një moment kur respektimi i afatit ligjor për Kërkesë për Rishqyrtim ishte bërë objektivisht i pamundur.

Dosja e Tenderit është publikuar si "**Version i korrigjuar 31.08.2026**", ndërsa afati për dorëzimin dhe hapjen e ofertave është caktuar më **04.09.2026 në ora 14:00**.

Sipas dispozitave të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për Rishqyrtim kundër dokumenteve të tenderit duhet të parashtrohet së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për ofertim. Në rastin konkret, AK ka publikuar dokumentacionin e korrigjuar kur ky afat nuk mund të respektohej më. Pra, për të qenë formalisht brenda afatit, MONUNI SH.P.K. do të duhej të kundërshtonte një dokument **para se ai dokument të publikohej**.

Kjo nuk përbën vonesë apo neglizhencë të operatorit ekonomik, por **pamundësi të krijuar ekskluzivisht nga veprimi i Autoritetit Kontraktues**.

2. MONUNI SH.P.K. ka vepruar menjëherë pas publikimit të dokumentacionit të korrigjuar, megjithatë AK e ka përdorur afatin që vetë e ka bërë të pamundur për ta hedhur kërkesën si të palejuar.

MONUNI SH.P.K. ka parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim më **01.09.2026**, ndërsa AK me Vendimin e datës **02.09.2026** e ka hedhur atë si të palejuar, duke u bazuar në afatin e paraqitjes. Vetë vendimi i AK-së evidenton se kërkesa është paraqitur më 01.09.2026 kundër Dosjes së Tenderit/B54 të korrigjuar.

Në këtë mënyrë krijohet një rezultat juridikisht i papranueshëm: **AK së pari publikon korrigjimin aq vonë sa OE nuk mund ta respektojë afatin pesëditor, dhe më pas pikërisht mosrespektimin e atij afati e përdor për t'ia mohuar OE-së shqyrtimin e kërkesës.**

Autoriteti Kontraktues nuk mund të përfitojë proceduralisht nga një situatë që e ka krijuar vetë.

3. Veprimi i AK-së ka cenuar në mënyrë efektive të drejtën e MONUNI SH.P.K. për mbrojtje juridike.

E drejta për paraqitjen e Kërkesës për Rishqyrtim nuk mund të jetë vetëm formale. Operatorit ekonomik duhet t'i jepet realisht mundësia që, pasi të njihet me aktin e AK-së, ta analizojë dhe ta kundërshtojë atë brenda afatit ligjor.

Në rastin konkret kjo mundësi nuk ka ekzistuar. Dokumentacioni i korrigjuar është publikuar aq afër hapjes sa afati për kundërshtimin e tij ishte praktikisht i pamundur për t'u respektuar. Si rezultat, me mënyrën e përcaktimit të afatit, AK jo vetëm ka shkurtuar kohën për ofertim, por ka cenuar edhe vetë funksionimin e mekanizmit të rishqyrtimit.

4. Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar afatin minimal pas publikimit të dokumentacionit të korrigjuar.

Pavarësisht publikimit të Dosjes së Tenderit të korrigjuar më 31.08.2026 dhe korrigjimit

përmes B54, afati për ofertim është lënë më **04.09.2026**.

Neni 53.7 i LPP-së dhe dispozitat përkatëse të Rregullores obligojnë AK-në që, kur informatat shitesë apo sqaruese jepen më pak se dhjetë ditë para ofertimit, ta zgjasë afatin në mënyrë që operatorëve ekonomikë t'u sigurohen së paku **dhjetë (10) ditë** nga dhënia e informacionit përkatës.

Pra këtu nuk kemi thjesht një vlerësim subjektiv se afati ka qenë i shkurtër; kemi **mosrespektim të një afati minimal të përcaktuar shprehimisht me dispozitat e prokurimit publik**.

6. Nuk plotësohen kushtet ligjore për përdorimin e afateve të përshpejtuara, sepse vetë arsyetimi i AK-së tregon se urgjenca është rezultat i vonesave të brendshme të Autoritetit Kontraktues.

AK e arsyeton përshpejtimin me faktin se sigurimi i mjeteve financiare nuk është realizuar me kohë për shkak të **vonesave në miratimin e buxhetit**, si dhe për shkak të nevojës për **harmonizim dhe koordinim ndërmjet drejtorive përkatëse**. AK deklaron më tej se vonesat e deritanishme kanë shkaktuar ngushtim të afateve.

Pra, vetë Autoriteti Kontraktues e pranon se situata është krijuar nga vonesat në planifikim, financim dhe koordinim administrativ.

Këto nuk janë rrethana të jashtme, të paparashikueshme apo të pakontrollueshme nga AK. Planifikimi buxhetor, sigurimi i financimit, koordinimi ndërmjet drejtorive dhe inicimi me kohë i aktivitetit janë përgjegjësi të vetë Autoritetit Kontraktues.

Rrjedhimisht, AK po tenton që **pasojat e vonesave të veta administrative t'ua bartë operatorëve ekonomikë përmes shkurtimeve të afateve**, gjë që bie ndesh me kushtet ligjore për përdorimin e procedurës së përshpejtuar.

7. Nuk ekziston as faktikisht urgjenca mbi të cilën AK pretendon ta bazojë përshpejtimin, sepse nevoja urgjente e sezonit aktual është mbuluar tashmë përmes një kontrate tjetër.

Komuna e Gjilanit ka zhvilluar aktivitetin tjetër të prokurimit nr. **651-26-5408-2-2-5**, "Dezinsektimi i hapësirave publike", me vlerë të parashikuar prej rreth **75,000.00 €**, përmes procedurës së negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë.

Përmes këtij aktiviteti është realizuar tashmë faza sezonale për të cilën Komuna kishte pretenduar ekzistimin e nevojës urgjente.

Ligjshmëria e asaj procedure është çështje tjetër dhe është kontestuar veçmas. Për këtë ankesë rëndësi ka fakti objektiv se **nevoja urgjente për sezonin aktual është mbuluar tashmë nga vetë Komuna përmes një kontrate tjetër**.

8. Faza e radhës nuk realizohet deri në qershor 2027, prandaj nuk ekziston pamundësi objektive për respektimin e afateve normale.

Pas realizimit të fazës së sezonit aktual, faza e radhës e shërbimeve përkatëse nuk parashihet deri në **qershor 2027**.

Kjo do të thotë se nga shtatori 2026 deri në fazën e ardhshme ekziston një periudhë prej shumë muajsh gjatë së cilës AK ka mundësi të zhvillojë procedurën në mënyrë të rregullt, duke respektuar plotësisht afatet ligjore.

Prandaj është e pabazuar të pretendohet se në shtator 2026 ekziston një urgjencë e tillë që e bën të pamundur respektimin e afateve normale, kur realizimi i radhës kërkohet vetëm në sezonin vijues.

9. Vetë arsyetimi i AK-së për karakterin sezonal të DDD-së e kundërshton përdorimin aktual të përshpejtimit.

AK deklaron në Dosjen e Tenderit se aktivitetet e Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit e kanë efektivitetin dhe funksionin kryesor gjatë **sezonit të verës**.

Nëse kjo është arsyeja e urgjencës, atëherë fakti që faza e sezonit 2026 është realizuar tashmë përmes kontratës tjetër, ndërsa faza e ardhshme është në sezonin 2027, e rrëzon vetë bazën faktike të arsyetimit për procedurën e përshpejtuar.

Nuk ekziston arsye objektive që në fillim të shtatorit 2026 të kufizohen afatet e operatorëve ekonomikë për një nevojë që është mbuluar për sezonin aktual dhe që do të paraqitet përsëri vetëm pas shumë muajsh.

10. Afati i përcaktuar nga AK kufizon drejtpërdrejt konkurrencën.

Për një aktivitet me vlerë 350,000.00 € dhe kohëzgjatje trevjeçare, operatorëve ekonomikë duhet t'u sigurohet kohë reale për analizimin e kërkesave, sigurimin e dokumentacionit, organizimin e stafit dhe pajisjeve dhe përgatitjen e ofertës.

Kur dokumentacioni përfundimtar publikohet vetëm disa ditë para ofertimit, zvogëlohet objektivisht numri i operatorëve që mund të përgatisin ofertë të përgjegjshme.

Një situatë e tillë **favorizon objektivisht operatorët që kanë qenë të përgatitur paraprakisht**, ndërsa operatorët e tjerë të interesuar nuk kanë kohë reale për të hyrë në konkurrencë.

Kjo bie ndesh me detyrimin e AK-së për ta zhvilluar aktivitetin në mënyrë që të sigurojë konkurrencë sa më të gjerë dhe jo ta reduktojë atë përmes afateve të pajustifikueshme.

11. Shkeljet e mësipërme janë të ndërlydhura dhe nuk mund të trajtohen si mangësi të izoluar procedurale.

AK fillimisht ka krijuar vonesa në planifikimin dhe koordinimin e vet; këto vonesa më pas i ka përdorur si arsyetim për procedurën e përshpejtuar; ka publikuar dokumentacionin e korrigjuar vetëm pak ditë para ofertimit; nuk ka respektuar afatin minimal pas korrigjimit; ka bërë të pamundur respektimin e afatit pesëditor për Kërkesë për Rishqyrtim; dhe në

fund e ka hedhur Kërkesën e MONUNI SH.P.K. si të palejuar pikërisht për shkak të atij afati.

Në këtë mënyrë, **pasojat e të gjitha vonesave dhe veprimeve të AK-së janë bartur te operatori ekonomik**, duke cenuar njëkohësisht kohën për përgatitjen e ofertës, konkurrencën dhe të drejtën për mbrojtje juridike.

Për këto arsye kërkojmë që OSHP t'i shqyrtojë këto rrethana në tërësinë e tyre dhe të konstatojë se vazhdimi i aktivitetit me afatin aktual nuk mund të konsiderohet në përputhje me LPP-në dhe Rregulloren për Prokurimin Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet administrative dhe profesionale për përgatitjen dhe përcjelljen e aktivitetit të prokurimit.

Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe ankesës pranë OSHP-së.

Shpenzimet për angazhimin dhe mbajtjen e stafit profesional dhe të kualifikuar për realizimin e shërbimeve DDD.

Humbja e mundshme e kontratës me vlerë të parashikuar prej 350,000.00 €.

Humbja e të ardhurave dhe fitimit potencial nga realizimi i kontratës.

Humbja e një reference të rëndësishme profesionale nga realizimi i një kontrate trevjeçare DDD.

Humbja e mundësive për kualifikim dhe pjesëmarrje në tenderë të ardhshëm ku kërkohej kontrata dhe referenca të natyrës së ngjashme.

Humbja e pozitës konkurruese dhe e pjesës së tregut në fushën e shërbimeve DDD.

Shpenzimet dhe dëmet tjera materiale që mund të lindin si pasojë e vazhimit të aktivitetit në kundërshtim me dispozitat ligjore.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*